

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ, sipas gjyqtarit Arben Hoti, me pjesëmarrjen e sek.juridike Fatmire Mani, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Fatmir Azizi, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të ligjit 04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë ,e në bazë të neni. 31.73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 13.11.2012 muarr:

A K T V E N D I M

I pandehuri: Fatmir Selajdin Azizi i lindur me 15.09.1977 në Ferizaj, me vendbanim në rr."Agim Matoshi" nr.11 Ferizaj.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse deri me datë 31 mars të vitit 2012, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë në cilsinë e Këshilltarit Komunal të Komunës së Ferizajit.

- me qka ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe neni 6 par. 1 pika 1.2 të ndëshkueshme me nenin 17 par.1 pika 1.2 të Ligjit Nr.04/L-050.
- andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore,e në vështrim të nenit 9 të LK.

D E N O H E T

ME DENIM NË GJOBË në shumë prej 300 €

Dënimin e shqiptuar në të holla ka për ta paguar në afatin prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi,në të kundërtën do ti zëvendësohet në dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 ditësh.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore, të paguaj shumën paushale prej 5.- € .në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Nga një ekzemplarë të këtij aktvendimi iu dërgohet palëve dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit e Republikës së Kosovës, në vazhdim Agjencioni, ushtror kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-2188/2012 kundër të pandehurit Fatmir Azizi për shkak të kundërvajtjes mos deklarim i pasurisë me kërkesë të Agjencisë të zyrtarit të lartë publik, nga neni 5, 6 pika 1.3 dhe 9 të ligjit 04/L-050, duke kërkuar që të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari filloj procedurën kundërvajtëse, analizoj provat që gjinden në shkresat e lëndës, mori në pyetje të pandehurin si dhe dëshmitarët.

I pandehuri në deklaratën e tij theksoi se ai i ka plotësuar folmularët për deklarimin e pasurisë në afatin e paraparë ligjorë dhe se të njejtit i ka dorzuar te referenti i Kuvendit Komunal të Ferizajit i quajtur Musa, dhe shtoj se nuk ka njohuri se pse referenti nuk e ka dorzuar formularin për deklarimin e pasurisë në Agjencion. Poashtu i pandehuri i dorzoi gjykatës vërtetimin për deklarimin e pasurisë të datës 11.09.2012.

DPK/DMP

03-4385/12
07-12-2012

03-4385/12/02
slg

Dëshmitari Musa Shabani në dëshminë e tij në cilsinë e Zyrtarit Për Pune të Komunës së Ferizajit ka theksuar se pasi u informova nga Fatmir Azizi se Agjencioni Kundër Korrupsionit ka bërë kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse ndaj tij, i njeji ma bëri me dije se formularin për deklarimin e pasurisë e ka dorzuar tek unë, dhe pas verifikimit të dosjeve, është e vërtetë se e kam gjetë formularin në emër të Fatmir Azizit të cilin ia ka dorzuar gjykatës si provë, dhe shton se as ai vet nuk e di se si e ka pranuar këtë formular, pasi që nuk e ka pasë obligim ta bëjë një gjë të tillë, mirpo pandehë se ka mund të ndodhë që në vulgun e punës të mos i ketë kushtuar vëmendje dhe ta ketë pranuar, ndërsa datën e arritjes së formularit në zyrën e tij nuk ka mundur ta përcaktoj. Deklarataës së këtij dëshmitari gjyqtari ia fali besimin, dhe e vërtetoi faktin se i pandehuri e kishte plotësuar dhe dorzuar folmularin për deklarimin e pasurisë ashtu siq kishte deklaruar në deklaratën e tij, mirpo në anën tjetër gjyqtari nuk mundi ta përcaktoj datën e dorzimit as nga deklarata e dëshmitarit, e as nga prova materjale formulari për deklarimin e pasurisë në emër të pandehurit, pasi që nuk është plotësuar rubrika data e dorzimit të formularit. Poashtu nga deklarata e këtij dëshmitari gjyqtari e vërtetoi faktin se i pandehuri formularin për deklarimin e pasurisë e ka dërguar në adresë të gabuar, dhe duke u nisur nga parimi "ignorantia iuris non excusat", që do të thotë se mosnjohaja e ligjit nuk amneston apo nuk falë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ngase i pandehuri në cilsinë e zyrtarit të lartë publik ka qenë i obliguar që ti marr të gjitha veprimet për raportim të rregullt, dhe formularin ta dorzoi në adresën e duhur, pra në Agjencion, pasi që në mënyrën se si ka vepruar ai ka dështuar që ta bëjë raportimin e rregullt vjetor për vitin 2012.

Gjatë caktimit të dënimit u morën parasysh të gjitha rrethanat si gjendja ekonomike e të pandehurit, si dhe rrethanat e parapara me nenin 9 të LK, dhe u konstatua se në rastin konkret me kundërvajtje nuk janë shkaktuar pasoja të rënda, ndërsa ekzistojnë rrethana lehtësuese që janë: se i pandehuri e ka plotësuar formularin edhe pse nuk e ka dërguar në Agjencion, dhe se pas vënjes në dijeni se ndaj ti është inicuar procedura kundërvajtëse i njeji e ka deklaruar pasurinë dhe për këtë e ka dorzuar vërtetimin e datës 11.09.2012, arsye këto që vëjnë në dukje se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjyqtari në këtë qështje kundërvajtëse aplikoi dispozitat e nenit 5 dhe nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 dhe dispozitën ndëshkimore të paraparë me nenin 17 par.1 pika 1.2 të ligjit Nr.04/L-050, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me raportim të rregullt vjetor.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë **Gjykatës së Lartë Për Kundërvajtje në Prishtinë** brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi ,përmes kësaj Gjykate pa pagesë takse.

Vendosur në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj.

Sek.juridike
Fatmire Mani-Haxhijaj

